

AKT-THEMELIMI

I SHOQËRISË " 7 DHJETORI"sh.p.k.

Unë Ing.Shkëlqim Bunçi në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi vendosa:

Neni 1

Të krijoj një shoqëri sh.p.k., të vetme për të ushtruar veprimtari ekonomike me emërtimin:

Shoqëria " 7 Dhjetori"sh.p.k., -Tiranë (në poshtë e quajtur "Shoqëria

Neni 2

Shoqëria ka statusin e personit juridik të së drejtës shqiptare. Ajo fiton statusin e personit juridik me regjistrimin në Gjkatën e Rrethit Tiranë.

Qendra e shoqërisë do të jetë në Tiranë, Rr. "Kavajës (ish Drejtoria e Ndërmarrjes 21 Dhjetori).

Neni 3

Veprimtaria e Shoqërisë, marrëdhëniet që lindin nga ky akt-themelimi si dhe marrëdhëniet e saj me personat e tjerë juridik shqiptar, rregullohen sipas dispozitave të këtij akt-themelimi, nga statuti i kësaj shoqërie si dhe nga legjislacioni shqiptar. Statuti i Shoqërisë i bashkëlidhet këtij akt-themelimi dhe është pjesë përbërse e tij.

Neni 4

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj: në fushën e ndërtimeve e projektive ndërtimore në përgjithësi, ndërtimin e objekteve të ndryshme; eksport-importin, prodhimin dhe tregëtimin e paisjeve e materialeve të ndërtimit; shitjen, blerjen, marrjen me qira si dhe dhënien me qira të çdo lloj pasurie të lujtshme e të palujtshme; transportimin e mallrave të lëndëve të para e të udhëtarëve; projektimin ndërtimin dhe shfrytëzimin e strukturave të ndryshme turistike; organizimin e reklamave; në fushën e komisionerisë si dhe çdo gjë tjetër që është e nevojshme për realizimin e qëllimeve të nësipërme.

Neni 5 . . .

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 lekë dhe përbëhet nga shumat e derdhura në para nga "Ortaku i vetëm" Ing. Shkëlqim Bunçi.

"Ortaku i vetëm" Ing. Shkëlqim Bunçi ruan të drejtën e propozimit mbi kapitalin themeltar të Shoqërisë.



Shuma e kapitalit themeltar e përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni ndahet në 100 pjesë të barabarta, ku vlera e një pjese është 1.000 lekë dhe përfaqëson një votë.

Neni 6

Fitimi i realizuar nga Shoqëria pas zbritjes së amortizimit, zbritjes së fondeve të tjera, dhënies së shpërblimeve të ndryshme, shlyerjes së detyrimeve ligjore do ta gëzojë "Ortaku i vetëm" Ing. Shkëlqim Bunçi.

Neni 7

"Ortaku i vetëm" Ing. Shkëlqim Bunçi do të përballojë humbjet eventuale të Shoqërisë vetëm me kapitalin themeltar të Shoqërisë.

"Ortaku i vetëm" nuk përgjigjet me pasurinë e tij personale për detyrimet e Shoqërisë.

Neni 8

Me pëlqimin e "Ortakut të vetëm" Ing. Shkëlqim Bunçi mund të pranohen dhe ortakë të tjerë nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit në këtë Shoqëri, si shtetas shqiptar ashtu dhe të huaj.

Ortakëve të rinjë nuk mund t'ju transferohen më shumë se 49% e pjesëve të kapitalit themeltar. Ata do të pranohen si ortakë në këtë Shoqëri vetëm pasi të kenë pranuar të drejtat dhe detyrimet në Shoqëri si dhe rregullat dhe rregulloret e punëve e të organizimit të punës të saj.

Neni 9

Organet e Shoqërisë:

"Ortaku i vetëm" Ing. Shkëlqim Bumçi do të ushtroj të gjitha kompetencat që me ligj i janë caktuar asamblesë së ortakëve.

Administratori i Shoqërisë do të jetë "Ortaku i vetëm" Shkëlqim Bumçi

Neni 10

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë caktohet për një periudhë kohe deri në 49 vjetë me mundësinë e zgjatjes së këtij afati.

Neni 11

Për kryerjen e veprimtarisë së saj Shoqëria mund të hapë filiale dhe zyrat e saj të përfaqësimit në qytete të tjera të Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vëndeve ku ato të hapen.

Neni 12

Ma. rëndësit e punës në Shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe për çështjet që nuk rregullohen në kontratën e punës zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar të punës.

Neni 13

akt

Kjo themelohet në fuqi me nënshkrimin e saj.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ 1994

"O R T A K U I V E T Ë M"

Ing. SHKËLQIM BUMÇI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
N O T E R I A

Nr. 187 Rep.

Nr. 50 Kol.

V E R T E T I M

Sot, më datë 11-08-1994 në zyrën e noterisë së rrethit Tiranë para meje noter i këtij rrethi u paraqit personalisht Ing. Shkëlqim